

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Lidhur sot në Tiranë, më datë 04 / 04 / 2024, ndërmjet palëve të mëposhtme:

DHURUESI

Znj. Violca BUSHATI, e bija e Myftarit, lindur më 15.11.1950, në Ersekë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal F06115017U, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (**në cilësinë e Dhurueses**).

Dhe

PRANUESI I DHURIMIT

Z. Ervin BUSHATI, i biri i Alfredit, lindur më 15.10.1975, në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H51015119N, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (**në cilësinë e Pranuesit**).


Dhuruesja Znj. Violca Bushati është titullare e 187,451 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) aksioneve të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., shoqëri anonime e regjistruar në Regjistrin Tregtar, me vendimin nr. 28969, datë 31.03.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vlerë nominale 1 USD, sic rezulton nga dokumentat e shoqërisë.

Dhuruesja dëshiron të transferojë në favor të Pranuesit të Dhurimit pa kundërshtpërblim, 187,451 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., që zotëron Dhuruesja, të cilat kanë një vlerë nominale 1 (një) aksion = 1(një) Usd. Pranuesi i dhurimit Z. Ervin Bushati është dakord dhe pranon dhurimin e aksioneve nga Dhuruesja.

Kështu, me përfundimin e këtij transaksioni dhurimi, Znj. Violca Bushati nuk do të zotërojë më aksione në kapitalin e shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., ndërsa Z. Ervin Bushati do të zotërojë 187,451 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., duke u bërë kështu aksioner i "BANKA CREDINS" SH.A.

Referuar nenit 9.5/a, të Statutit të shoqërisë "BANKA CREDINS" SH.A., dhuruesja Znj. Violca Bushati përmes kësaj kontrate ushtron të drejtën e saj të transferimit të aksioneve nëpërmjet dhurimit të tyre Z. Ervin Bushati.

ATËHERË



Palët bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, Dhuruesja i dhuron Pranuesit dhe ky i fundit pranon prej saj paketën prej 187,451 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) aksionesh, të cilat Dhuruesja zotëron në kapitalin e "BANKA CREDINS" SH.A.

Neni 2

Transferimi i Titullit

Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit pranon të bëhet titullar i ligjshëm i paketës prej 187,451 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) aksionesh, që Dhuruesja zotëron në kapitalin e "BANKA CREDINS" SH.A, dhe Dhuruesja zhvishet nga cdo e drejtë mbi këto aksione.

Neni 3

Të ndryshme

Kjo kontratë Dhurimi përbën marrëveshjen midis palëve në lidhje me objektin e mësipërm.

Neni 4

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.

TË TJERA

Kjo Kontratë Dhurimi hartohet në 4 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar, ku nga një kopje është për secilën palë nënshkruese dhe dy kopje depozitohen në "BANKËN CREDINS" SH.A.

DHURUESE

Viollca BUSHATI

Viollca Bushati
(Signature)

PRANUESI I DHURIMIT

Ervin BUSHATI

Ervin Bushati
(Signature)